



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8256/79 Prot

Shkodër, më 1.11.2021

MARRËVESHJE KUADËR

PËR SHËRBIME ME OBJEKT: GJIMNASTIKA VLLAZNIA

Kjo marreveshje lidhet sot, më datë 1/11/2021 ndermjet:

BASHKISË SHKODËR me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si "**Bashkia**"

dhe

SHOQATA E GJIMNASTIKËS, me seli lagjia 'Vasil Shanto' nr.4, Shkodër, përfaqësuar nga z. Leonard Lulaj me nr. NIPT-i M16825131V, në cilësinë e kryetarit të shoqatës, në vijim referuar edhe si "**Ekipi i Gjimnastikës Vllaznia**".

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si "Pala" ose "Palët".

Duke qënë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e promovimit të territorit, përmes aktiviteteve artistike kulturore.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës sportive në territorin e Bashkisë Shkodër.

Synojnë realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Njohin eksperiencën e Shoqatës së Gjimnastikës, në organizimin e aktiviteteve të sportive në Shqipëri.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit "Gjimnastika Vllaznia".



Neni 1 Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- 1.4 Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar;
- 1.5 VKM nr.354, dt 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë të veprimtarive sportive, për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime te tjera sportive”, i ndryshuar
- 1.6 VKM nr 687 date 14.11.2018 “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, të ndryshuar.
- 1.7 VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”;
- 1.8 VKB nr. 63 datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”;
- 1.9 VKB nr. 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi ‘Sport dhe Argëtim’, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të klubit sportiv ‘Vllaznia’ ”.
- 1.10 Urdhër nr. 784, datë 18.08.2021 “Për zbatimin e projekteve të shpallura fituese në thirrjen publike për organizatat e shoqërisë civile, sipas udhëzuesit për zbatimin e projekteve në kuadër të metodologjisë LOD, Programi Reload.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës së Gjimnastikës, për zbatimin e projektit “Gjimnastika Vllaznia”, të gjithë ekipeve zinxhir me synimin e zhvillimit të sportit të gjimnastikës në Bashkinë e Shkodrës dhe të marrë pjesë në kampionate kombëtare në të gjitha kategoritë sportive të gjimnastikës.

Neni 3 Objekti i Marrëveshjes

1. Rritja dhe zhvillimi i gjimnastikës, duke e çuar atë në nivel strategjik për pjesëmarrje në gara kombëtare dhe ndërkombëtare me rezultate çmimesh të para



Neni 4
Afati i Marrëveshjes

4.1 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 24 (njëzet e katër) muaj.

Neni 5
Vlera e Marrëveshjes

5.1 Marrëveshja lidhet për një vlerë totale prej 1 323 000 (një milion e treqind e njëzet e tre mijë) lekë pa tvsh.

5.2 Financimi realizohet sipas viteve në lekë:

Viti 2021: 342 000 lekë

Viti 2022: 654 000 lekë

Viti 2023: 327 000 lekë.

5.3 Kontratat lidhen për çdo vit buxhetor.

Neni 6
Dispozita të tjera

19.1 Pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj marrëveshjeje do të jenë:

- Projekt Propozimi.
- Buxhetin bashkelidhë.
- Plani i aktiviteteve në një periudhë të caktuar kohore.
- Tabela indikatorëve mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i përfundimit.

19.2 Kjo marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

19.2.1 Kjo marrëveshje u hartua në 4 kopje nga të cilat njëri e merr Subjekti fitues ndërsa tre të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR BASHKINË SHKODËR

Kryetar

Volana Ademi

PËR SHOQATËN

Kryetar

Leonard Lulaj